



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 4414 / prot.
11

Tiranë, më 08.09.2021

URDHËR

Nr. 519, datë 08.09.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË DISIPLINËS PËR POLICINË E
BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, dhe të nenit 45, pika 5, dhe nenit 49, pika 2, të ligjit nr. 80/2020, "Për Policinë e Burgjeve",

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Rregullores së disiplinës për Policinë e Burgjeve", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullore e Çështjeve të Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore për ndjekjen dhe zbatimin e tij.
3. Urdhri nr. 3146, datë 16.4.2009, "Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Apelit të Masave Disiplinore", i ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Etilda Gjona
Etilda Gjona (Saliu)



RREGULLORJA E DISIPLINËS SË POLICISË SË BURGJEVE

KREU I OBJEKTI DHE QËLLIMI

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore përcakton:

- a) kategoritë dhe llojet e shkeljeve disiplinore;
- b) kriteret, rregullat dhe procedurat për dhënien e masave disiplinore;
- c) organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Apelit të Masave Disiplinore.

KREU II SHKELJET DISIPLINORE

Neni 2 Shkeljet disiplinore

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyshje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e punonjësit të Policisë së Burgjeve konsiderohet shkelje disiplinore ose është e lidhur vetëm me vlerësimin e veprimtarisë profesionale, merret parasysh:

- a) shkalla e pakujdesisë;
- b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;
- c) përvoja dhe pozicioni i punonjësit në Policinë e Burgjeve;
- ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe
- d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të punonjësit të Policisë së Burgjeve dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit penitenciar.

Neni 3 Kategoritë e shkeljeve disiplinore

Shkeljet disiplinore të Policisë së Burgjeve ndahen në:

- a) shkelje shumë të rënda;
- b) shkelje të rënda;
- c) shkelje të lehta.

Llojet e shkeljeve disiplinore

1. Janë shkelje shumë të rënda:

- a) mospërbushja e rëndë e detyrave;
- b) mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuar në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;
- c) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale;
- ç) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 5 ditë pune ose më shumë;
- d) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës;
- dh) fshehja, ndryshimi ose asgjësimi i dokumenteve zyrtare në formë shkresore ose elektronike;
- e) përsëritja e një shkeljeje të rëndë disiplinore, për të cilën është në fuqi një masë disiplinore;
- ë) përdorimi, në mënyrë të përsëritur, i statusit si punonjës i Policisë së Burgjeve, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;
- f) mosmarrja nga eprori e masave të nevojshme për parandalimin e pasojave të mëtejshme në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore të kryera nga vartësit e tyre;
- g) anëtarësimi në një parti politike ose shprehja publikisht e bindjeve ose preferencave politike gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Janë shkelje të rënda:

- a) mospërbushja e detyrave;
- b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 3 ditë pune ose më shumë;
- c) shkelje e përsëritur e rregullave të etikës;
- ç) sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;
- d) dëmtimi me dashje i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të automjeteve, mjeteve teknike apo pajisjeve të Policisë së Burgjeve për interesa privatë, ose lejimi i përdorimit të tyre prej personave të tjerë;
- dh) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të detyrës që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të statusit si punonjës i Policisë së Burgjeve;
- e) shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla;
- ë) moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të eprorëve, kur kanë sjellë pasoja;
- f) ushtrimi i detyrës në kushtet e konfliktit të interesit;
- g) shkelje e kërkesave dhe e rregullave për garantimin e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- gj) përdorimi ose lejimi i përdorimit të forcës në mënyrë të paligjshme;
- h) mbajtja e armës së zjarrit në kundërshtim me normat dhe rregullat e vendosura;

Neni 5

Llojet e masave disiplinore

Masat disiplinore, që zbatohen ndaj punonjësve të Policisë së Burgjeve, janë si më poshtë:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) shtyrje e afatit të ngritjes në gradë për 1 vit;
- ç) largim nga Policia e Burgjeve.

Neni 6

Autoritetet për dhënien e masave disiplinore

1. Autoritetet për dhënien e masave disiplinore janë ministri i Drejtësisë, drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, drejtori i Policisë së Burgjeve dhe drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale (këtu e në vijim "IEVP").

2. Ministri i Drejtësisë jep masat e mëposhtme disiplinore:

a) "Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit", për punonjësit e rolit të lartë, pas propozimit të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve;

b) "Largim nga Policia e Burgjeve", për drejtorin dhe përgjegjësit e sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, pas propozimit të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve.

3. Drejtori i përgjithshëm i burgjeve jep masat e mëposhtme disiplinore:

a) "Vërejtje me shkrim" dhe "Vërejtje me paralajmërim", për punonjësit e Policisë së Burgjeve, që ushtrojnë detyrën në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve, kryesisht ose me propozimin e drejtorit të Policisë së Burgjeve;

b) "Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit", për punonjësit e rolit të mesëm, pas propozimit me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve;

c) "Largim nga Policia e Burgjeve", për punonjësit e rolit bazë dhe për punonjësin në periudhë prove, në cilësinë e aspirantit, pas propozimit me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve.

3. Drejtori i Policisë së Burgjeve jep masën disiplinore "Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit" për punonjësit e rolit bazë dhe për punonjësin në periudhë prove, në cilësinë e aspirantit, pas propozimit të drejtorit të IEVP-së.

4. Drejtori i IEVP-së jep masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" dhe "Vërejtje me paralajmërim", për punonjësit e Policisë së Burgjeve, që ushtrojnë detyrën në IEVP, kryesisht ose me propozimin e shefit të Policisë së Burgjeve.

Neni 7

Fillimi i procedurës disiplinore

1. Çdo punonjës i Policisë së Burgjeve, si dhe çdo nëpunës ose punëmarrës i IEVP-së ose i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga punonjësit e Policisë së Burgjeve, duhet t'i raportojnë atë, me shkrim: drejtorit të IEVP-së ku ushtron detyrën punonjësi i Policisë së Burgjeve, që dyshohet

që ka kryer shkeljen disiplinore; drejtorit të Policisë së Burgjeve ose drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve.

2. Kur shkeljet janë konstatuar nga shtetas apo institucione jashtë strukturave të Drejtorisë së Burgjeve, ato i raportohen zyrtarisht institucionit përkatës.

3. Kërkesa/rekomandimi, në lidhje me shkeljen disiplinore të dyshuar, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të plotësojë këto kushte:

a) të jetë me shkrim;

b) të identifikojë punonjësën e Policisë së Burgjeve, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.

4. Kërkesat anonime nuk pranohen për shqyrtim, përveç kur nga verifikimi paraprak rezulton se të dhënat e paraqitura përmbajnë informacion të mjaftueshëm për të filluar një proces disiplinor për shkeljen e pretenduar.

5. Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore mund ta paraqesin edhe të burgosurit. Në këtë rast, kërkesa mund të paraqitet edhe verbalisht, përpara çdo punonjësi të Policisë së Burgjeve, i cili është i detyruar ta dokumentojë atë me shkrim dhe, pasi të lexohet, të nënshkruhet nga i burgosuri, si dhe punonjësi i Policisë së Burgjeve që administron kërkesën. Kërkesa regjistrohet menjëherë në librin e protokollit të IEVP-së dhe i dërgohet drejtorit të institucionit, drejtorit të Policisë së Burgjeve ose drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 8

Mosmarrëveshjet e kompetencave

1. Në rast se për dhënien e një mase disiplinore, konkurrojnë kompetencat ndërmjet dy ose më shumë autoriteteve kompetente për dhënien e masave disiplinore, mosmarrëveshja e kompetencave zgjidhet me marrëveshje me shkrim midis tyre.

2. Në rast se ato nuk arrijnë në një marrëveshje, konflikti zgjidhet nga ministri i Drejtësisë. Zgjidhja e konfliktit mund të kërkohej nga secili prej autoriteteve kompetente të përfshira, me marrjen dijeni të konfliktit.

3. Konflikti zgjidhet brenda 10 ditëve nga dita e depozitimit të kërkesës.

Neni 9

Hetimi disiplinor

1. Autoriteti që ka administruar kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore, sipas neni 7 të kësaj rregulloreje, pasi e vlerëson paraprakisht atë, ia dërgon autoritetit kompetent për propozimin ose autoritetit kompetent për dhënien e masës disiplinore, në rastet kur masa mund të jepet edhe kryesisht, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve, si dhe kësaj rregulloreje.

2. Nëse informacioni i marrë nuk rezulton të ketë elemente, që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, autoriteti kompetent për propozimin ose dhënien e masave disiplinore vendos të mos e fillojë ecurinë disiplinore.

3. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente të klasifikuara si shkelje disiplinore, organi kompetent bën klasifikimin e shkeljeve, sipas neneve 3 dhe 4, të kësaj rregulloreje dhe fillon hetimin disiplinor, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së kërkesës.

4. Nëse shkelja që i atribuohet punonjësit të Policisë së Burgjeve rezulton se nuk është klasifikuar drejt apo nuk është në juridiksionin lëndor të autoritetit që e ka marrë në shqyrtim kërkesën, atëherë ai vendos dërgimin me shkresë zyrtare pranë autoritetit kompetent.

5. Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, autoriteti kompetent për propozimin ose autoriteti kompetent për dhënien e masës disiplinore, në rastet kur masa mund të jepet edhe kryesisht, fillon ecurinë disiplinore dhe njofton, me shkrim, punonjësin përkatës të Policisë së Burgjeve:

- a) për shkeljen disiplinore të pretenduar për të;
- b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
- c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre.

6. Autoriteti kompetent për propozimin e masës disiplinore ose autoriteti kompetent për dhënien e masës disiplinore, në rastet kur masa mund të jepet edhe kryesisht, heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes, që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative e, në veçanti, ai kryen veprimet e mëposhtme:

- a) pyet ose merr deklaratat nga dëshmitarët dhe verifikon faktet kundërshtuese;
- b) rishikon dokumentacionin përkatës për mospërputhje, për fakte që mungojnë, data apo firma që janë hequr etj.;
- c) shqyrton dosjen e nëpunësit;
- ç) thërret nëpunësin për t'u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit;
- d) verifikon praktikën dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;
- dh) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes.

7. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas këtij neni, autoriteti kompetent i vë në dispozicion punonjësit ndaj të cilit po kryhen hetimet, materialet e mbledhura gjatë këtij hetimi.

Neni 10

Mbyllja e hetimit disiplinor

1. Autoriteti kompetent mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit, se:

- a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;
- b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm, që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;
- c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;
- ç) punonjësi është liruar nga Policia e Burgjeve, sipas nenit 52 të ligjit për Policinë e Burgjeve;
- d) punonjësi i Policisë së Burgjeve ka vdekur.

2. Autoriteti kompetent duhet t'i njoftojë vendimin punonjësit të Policisë së Burgjeve të interesuar ose përfaqësuesit të tij, ankuesit, dhe autoritetit përkatës që mund të merrte masën disiplinore. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për mbylljen e hetimit, sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi tregon të drejtën e ankuesit për të ankimuar këtë vendim në autoritetin përkatës që mund të merrte masën disiplinore. Ankuesi ka të drejtë t'ia ankimojë këtë vendim autoritetit përkatës, që mund të merrte masën disiplinore, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

3. Faktet e zbuluara gjatë hetimit, të cilat nuk justifikojnë propozimin e një mase disiplinore, por që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e punës, duhet t'i paraqiten organit përgjegjës, që kryen vlerësimin në punë të punonjësit të Policisë së Burgjeve.

Neni 11

Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar e punonjësit të Policisë së Burgjeve

1. Nëse ka dyshime të arsyeshme që punonjësi i Policisë së Burgjeve ka kryer shkelje disiplinore, autoriteti kompetent i propozon dhënien e masës disiplinore autoritetit për dhënien e masës disiplinore, sipas përcaktimit të nenit 47, të ligjit për Policinë e Burgjeve, si dhe nenit 6, të kësaj rregullore, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore, të cilat përmbledhin faktet, listën e provave dhe rëndësinë e tyre, si dhe konkluzionet që argumentojnë nëse këto fakte mund të përbëjnë shkelje të detyrimeve të Policisë së Burgjeve, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

2. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve njoftohet se ndaj tij është propozuar marrja e një mase disiplinore, duhet që t'i bëhen të ditura:

- a) autoriteti kompetent për marrjen e masës disiplinore që zhvillon procedurën;
- b) informacioni për të drejtën e inspektimit të dosjeve, zyra dhe vendi ku kjo mund të ushtrohet;
- c) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimi përkatës;
- ç) informacioni për të drejtën e palës për t'u dëgjuar, mënyra dhe afati i ushtrimit të kësaj të drejte;
- d) data e fillimit të procedurës dhe afati kohor, brenda të cilit do të merret dhe do të njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm.

3. Autoriteti kompetent për dhënien e masës disiplinore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar:

a) njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar; autoriteti kompetent mund të vendosë që kjo e drejtë të mund të ushtrohet përgjatë një periudhe jo më të shkurtër se 5 ditë dhe jo më të gjatë se 30 ditë.

b) në rastet kur vendos që e drejta për t'u dëgjuar të ushtrohet nëpërmjet një seance dëgjimore, njofton palët për datën e seancës dëgjimore të paktën 15 ditë para saj.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, në ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mund të paraqesë komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës. Autoriteti kompetent për dhënien e masës disiplinore mund t'i kërkojë punonjësit të Policisë së Burgjeve të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo

lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore, kur vendoset që e drejta për t'u dëgjuar të ushtrohet nëpërmjet një seance dëgjimore.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre. Brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, autoriteti kompetent për dhënien e masës disiplinore i siguron punonjësit të Policisë së Burgjeve kushtet për njohjen me dosjen dhe i vë në dispozicion kopje të dokumenteve.

6. E drejta e aksesit me dosjen mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) të drejtave themelore të një personi tjetër; ose
- b) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar; ose
- c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;
- ç) barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor.

7. E drejta e aksesit kufizohet për atë kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme. Në çdo rast, punonjësi i Policisë së Burgjeve ose përfaqësuesi i tij ka akses në dosje para se autoriteti kompetent të marrë vendimin.

Neni 12

Kriteret për caktimin e masës disiplinore

1. Në rast se provohet shkelja disiplinore, autoriteti kompetent cakton një masë disiplinore, duke marrë parasysh rrethanat e mëposhtme:

- a) llojin dhe rrethanat e shkeljes;
- b) shkallën e fajësisë dhe motivin;
- c) pasojat e shkeljes;
- ç) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore;
- d) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen;
- dh) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të punonjësit të Policisë së Burgjeve;
- e) sjelljen e punonjësit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit, si dhe qëndrimin që mban ndaj tij;

ë) çdo çështje tjetër që autoriteti kompetent e konsideron të rëndësishme.

2. Autoriteti kompetent, kur vendos masën disiplinore:

- a) duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit;
- b) duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese.

3. Në caktimin e masës merren parasysh rrethanat rënduese në vijim, kur:

- a) shkelja kryhet më shumë se një herë;
- b) shkelja ka zgjatur në kohë;
- c) shkelja kryhet për shkak të motiveve diskriminuese;
- ç) shkelja kryhet për motive të tjera të dobëta;
- d) punonjësit i Policisë së Burgjeve nxit të tjerët të kryejnë shkelje ose veprime të

paligjshme;

dh) shkelja kryhet duke shfrytëzuar dobësitë ose pozitën e cënueshme të të tjerëve;

e) shkelja disiplinore është kryer në publik;

ë) janë kryer më shumë se një shkeljeje disiplinore në të njëjtën kohë;
f) ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën organi kompetent çmon se rëndon shkeljen e kryer.

4. Në caktimin e masës ndaj punonjësit të Policisë së Burgjeve duhet të merren parasysh rrethanat lehtësuese në vijim:

- a) punonjësi i Policisë së Burgjeve e kryen shkeljen për herë të parë;
- b) shkelja e punonjësit të Policisë së Burgjeve ka pasur ndikim të vogël, duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes;
- ç) punonjësi bashkëpunon në hetimin dhe në procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon shkeljen e kryer ose jep informacione, që ndihmojnë në hetimin disiplinor;
- d) punonjësi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga shkelja ose ka ndihmuar për të zhdukur ose për të pakësuar pasojat e saj;
- dh) mungesa e përvojës në punë të punonjësit të Policisë së Burgjeve;
- e) ekziston çdo rrethanë tjetër që autoriteti kompetent e çmon se lehtëson shkeljen e kryer.

5. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

Neni 13

Arsyetimi i vendimit për marrjen e masës disiplinore

1. Vendimi për marrjen e masës disiplinore jepet i arsyetuar dhe përmban:

- a) Pjesën hyrëse, që përmban:
 - i. emrin e autoritetit kompetent, që merr masën disiplinore;
 - ii. punonjësin e Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret masa disiplinore, dhe gradën që ai mban;
 - iii. datën e miratimit;
 - iv. bazën ligjore;

- b) Pjesën arsyetuese;
- c) Dispozitivin, që tregon:
 - i. llojin e masës disiplinore të marrë;
 - ii. kohën e hyrjes në fuqi të aktit;
 - iii. të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.

2. Arsyetimi i vendimit për marrjen e masës disiplinore duhet të jetë i qartë dhe përmban:

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë masa disiplinore;
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast.

Neni 14

Njoftimi i masës disiplinore

1. Vendimi për masën disiplinore i njoftohet me shkrim punonjësit të Policisë së Burgjeve, brenda 5 ditëve pune nga marrja e tij. Njoftimi kryhet nga eprori i drejtpërdrejtë ose personi i autorizuar prej titullarit. Eprori dhe punonjësi i Policisë së Burgjeve, që ka marrë masën disiplinore, nënshkruajnë marrjen në dorëzim të njoftimit të vendimit për marrjen e masës disiplinore.

2. Një kopje e vendimit për dhënien e masës disiplinore administrohet nga struktura e personelit, e cila, pas përfundimit të afateve apo të procedurave të ankimit, e vendos në dosjen personale të punonjësit. Në rastet kur në përfundim të procedurave të ankimit, masa e dhënë anulohet, dokumentacioni përkatës i ecursë disiplinore arkivohet.

3. Kur punonjësi i ndëshkuar refuzon për të nënshkruar marrjen dijeni për vendimin mbi dhënien e masës disiplinore, punonjësi që i njofton vendimin e masës disiplinore, në prani të dy punonjësve të tjerë, ose përfaqësuesit të punonjësit të Policisë së Burgjeve, vendos shënimin "refuzon firmën".

KREU IV ANKIMI

Neni 15

E drejta e ankimit

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit është dhënë një masë disiplinore, ka të drejtë të ankohet pranë autoriteteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.

2. Pas përfundimit të ankimit administrativ, punonjësi ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore, ka të drejtën e ankimit në gjykatën administrative kompetente.

Neni 16

Përmbajtja e ankimit

1. Ankimi ndaj vendimit për dhënien e masës disiplinore duhet të përmbajë:

- a) punonjësin e Policisë së Burgjeve që ushtron ankimin administrativ;
- b) autoritetin kompetent që shqyrton ankimin;
- c) vendimin për dhënien e masës disiplinore, i cili kundërshtohet;
- ç) objektin dhe shkaqet për të cilat bëhet ankimi.

2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, çdo kërkesë drejtuar autoriteteve kompetente, sipas përcaktimit të nenit 48, të ligjit për Policinë e Burgjeve, vlerësohet si ankim ndaj vendimit për dhënien e masës disiplinore edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë. Në këtë rast, qëllimi për t'u ankuar ndaj vendimit për dhënien e masës disiplinore duhet të jetë mjaftueshëm i qartë.

Neni 17

Afatet e ankimit

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret një masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" ose "Vërejtje me paralajmërim", ka të drejtë të ankohet me shkrim tek eprori që ka dhënë masën ndaj tij, brenda 5 ditëve nga data e marrjes dijeni për dhënien e masës disiplinore.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret masë disiplinore "Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit" ose "Largim nga Policia e Burgjeve" ka të drejtë të ankohet me shkrim në Komisionin e Apelit të masave disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni me shkrim, për dhënien e masës.

Neni 18

Efektet e ankimit

Ankimi administrativ ndaj vendimit për dhënien e masës disiplinore, i paraqitur në përputhje me kërkesat e neneve 15-17 të kësaj rregulloreje, si dhe neneve 130-132 të Kodit të Procedurës Administrative, pezullon ekzekutimin e vendimit për dhënien e masës disiplinore deri në njoftimin e vendimit të ankimit.

Neni 19

Kushtet e pranimi të ankimit

Ankimi është i pranueshëm, nëse plotëson këto kushte:

- a) ankimi është paraqitur nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore ose një përfaqësues i tij i pajisur me prokurë;
- b) ankimi është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 17 i kësaj rregulloreje; dhe
- c) ankimi i është drejtuar autoritetit kompetent për shqyrtimin e ankimit, sipas nenit 48, të ligjit për Policinë e Burgjeve.

Neni 20

Shqyrtimi i ankimit nga eprori

1. Eprori të cilit i drejtohet ankimi, shqyrton dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës. Eprori fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm, sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje, dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e vendimit për dhënien e masës disiplinore.

2. Eprori, menjëherë, pasi çmon që ankimi është i pranueshëm, njofton njësinë përgjegjëse të personelit për vënien në dispozicion të një kopjeje të dokumentacionit të çështjes në shqyrtim dhe të procedurës disiplinore të ndjekur për punonjësin ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore. Nëse është e nevojshme, eprori zhvillon hetime administrative shtesë.

3. Eprori e shqyrton ankimin duke u bazuar në aktet ose dokumentet e administruara. Eprori mund të organizojë një seancë dëgjimore me ankuesin, në rastet kur vlerësohet e nevojshme thirrja dhe dëgjimi i ankuesit, si dhe i organit që ka marrë masën disiplinore, për shkak të problematikës ose të kompleksitetit të çështjes. Në këtë rast, palët njoftohen për zhvillimin e seancës dëgjimore të paktën 5 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e saj.

4. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe të provave të marra, eprori që shqyrton ankimin vendos:

a) lënien në fuqi të masës disiplinore kur e gjen të bazuar;
b) shfuqizimin saj nëse është dhënë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim; ose

c) rishikimin e saj nga autoriteti që ka dhënë masën, në këtë rast autoriteti kompetent është i detyruar të rishikojë masën disiplinore sipas arsyetimit të eprorit.

5. Eprori njofton për vendimin e marrë punonjësën e Policisë së Burgjeve që ka ushtruar ankimin, autoritetin që ka dhënë masën dhe njësinë përgjegjëse të personelit për administrimin e dosjes. Njësia përgjegjëse e personelit, me marrjen e këtij vendimi, e administron atë në dosjen personale të punonjësit dhe në sistemin elektronik të të dhënave.

6. Vendimi i eprorit që shqyrton ankesën është përfundimtar dhe ndaj tij mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 21

Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore

1. Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore (në vijim "Komisioni") krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Një prej anëtarëve të Komisionit kryen rolin e kryetarit të Komisionit.

3. Komisioni ndihmohet në veprimtarinë e tij nga personeli mbështetës, i cili përbëhet nga nëpunës civilë të strukturës përgjegjëse për monitorimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në Ministrinë e Drejtësisë, të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit. Periudha e angazhimit dhe numri i tyre caktohet sipas nevojave të përcaktuara nga Komisioni. Pasi caktohen, për këtë periudhë, këta punonjës kryejnë, sipas rastit dhe nevojës, me kohë të plotë apo të pjesshme, detyrat e ngarkuara nga Komisioni.

4. Përveç sa u kërkohet, rast pas rasti nga Komisioni ose kryetari, personeli mbështetës kryen veprime lidhur me hartimin e procesverbaleve të mbledhjes, hartimin e shkresave apo të akteve të ndryshme të Komisionit, njoftimin e kryetarit të komisionit për çdo ankim të paraqitur për shqyrtim, dërgimin dhe ndjekjen e njoftimeve, veprime të tjera të sekretarisë, si edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të Komisionit.

5. Përbërja e Komisionit caktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 22

Detyrimi i pjesëmarrjes në mbledhje dhe konflikti i interesave

1. Pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në mbledhjet dhe veprimtaritë e tij është e detyrueshme përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre.

2. Anëtari i Komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të Komisionit, lidhur me një çështje të caktuar, është i

detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës, të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe në votimin e saj.

3. Anëtarët e Komisionit, që janë në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore, nuk marrin pjesë në mbledhje, por, në çdo rast, njoftojnë menjëherë me shkrim kryetarin për pengesën ligjore për pjesëmarrjen në mbledhje.

Neni 23

Njoftimet për thirrjet e mbledhjes së Komisionit

1. Nëse nuk është vendosur ndryshe në mbledhjet e mëparshme të Komisionit, njoftimi për thirrjen e mbledhjes, i cili përmban rendin e ditës, datën, kohën e zhvillimit të mbledhjes, bëhet me shkrim së paku 3 ditë përpara datës që caktohet për zhvillimin e saj.

2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes, i cili përmban rendin e ditës, datën, kohën e zhvillimit të mbledhjes, u dërgohet të gjithë anëtarëve.

3. Së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes, sipas rasteve dhe natyrës së çështjeve të rendit të ditës, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të komunikimit, anëtarëve të Komisionit u dërgohet edhe dokumentacioni përkatës i përgatitur nga personeli administrativ.

4. Njoftimi i anëtarëve të Komisionit për zhvillimin e mbledhjes bëhet në rrugë elektronike apo të çdo mjeti tjetër të përshtatshëm komunikimi.

Neni 24

Punimet e mbledhjes së Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se 3 anëtarë të tij dhe vendos me shumicën e votave.

2. Në rast se në ditën e caktuar nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, Kryetari apo, sipas rastiit, anëtari që drejton mbledhjen, cakton një ditë tjetër sa më të afërt për zhvillimin e mbledhjes dhe njofton për këtë anëtarët e Komisionit që nuk ishin të pranishëm.

3. Kryetari deklaron fillimin e mbledhjes së Komisionit, verifikon prezencën e anëtarëve, duke informuar Komisionin për motivet e mungesës ose të pengesës së anëtarit të Komisionit që nuk është i pranishëm.

4. Kur verifikohet kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, kryetari paraqet çështjet e përcaktuara për shqyrtim në rendin e ditës. Komisioni merr vendime vetëm për çështjet të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

5. Pas miratimit të rendit të ditës, nëse anëtarët nuk ngrenë probleme të tjera të lidhura me ndonjërin prej rasteve të konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, Komisioni vijon me shqyrtimin e çështjeve.

6. Kryetari i Komisionit jep fjalën, drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të marrin fjalën lidhur me secilën çështje të rendit të ditës.

7. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e Komisionit shprehin qëndrimin dhe votojnë për zgjidhjen e çështjes. Kryetari i Komisionit shpreh qëndrimin dhe voton i fundit.

Neni 25

Marrja e vendimeve nga Komisioni

1. Komisioni shqyrton dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës. Komisioni fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm, sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje, jo më vonë se 10 ditë nga data e depozitimit të tij, dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e vendimit për dhënien e masës disiplinore.

2. Komisioni, menjëherë pasi çmon që ankimi është i pranueshëm, njofton autoritetin që ka dhënë masën disiplinore për vënien në dispozicion të një kopjeje të dokumentacionit të çështjes në shqyrtim dhe procedurës disiplinore të ndjekur për punonjësin ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore. Nëse është e nevojshme, Komisioni zhvillon hetime administrative shtesë.

3. Komisioni e shqyrton ankimin duke u bazuar në aktet ose dokumentet e administruara. Komisioni mund të organizojë një seancë dëgjimore me ankuesin, në rastet kur vlerësohet e nevojshme thirrja dhe dëgjimi i ankuesit, si dhe i organit që ka marrë masën disiplinore, për shkak të problematikës ose të kompleksitetit të çështjes. Në këtë rast, palët njoftohen për zhvillimin e seancës dëgjimore të paktën 5 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e saj.

4. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe të provave të marra, Komisioni vendos:

- a) lënien në fuqi të masës disiplinore kur e gjen të bazuar;
- b) shfuqizimin saj nëse është dhënë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim; ose
- c) rishikimin e saj nga autoriteti që ka dhënë masën; në këtë rast, autoriteti kompetent është i detyruar të rishikojë masën disiplinore sipas arsytimit të Komisionit.

5. Komisioni vendos me shumicën e votave në praninë e të paktën tre anëtarëve. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

6. Në rastin e lënies në fuqi të masës disiplinore, vendimi i Komisionit është i ekzekutueshëm që nga momenti i dhënies së masës disiplinore nga autoriteti i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për Policinë e Burgjeve.

7. Çdo vendim i Komisionit, që përfundon procedurën e shqyrtimit të ankimit, nënshkruhet nga kryetari dhe të gjithë anëtarët e tij dhe u njoftohet menjëherë palëve në proces.

8. Komisioni njofton për vendimin e marrë punonjësin e Policisë së Burgjeve që ka ushtruar ankimin, autoritetin që ka dhënë masën dhe njësinë përgjegjëse të personelit për administrimin e dosjes. Njësia përgjegjëse e personelit, me marrjen e këtij vendimi, e administron atë në dosjen personale të punonjësit dhe në sistemin elektronik të të dhënave.

9. Vendimi i Komisionit, që shqyrton ankesën, është përfundimtar dhe ndaj tij mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 26

Dokumentimi i mbledhjes

1. Kryetari i Komisionit është përgjegjës për të siguruar që personeli administrativ i vënë në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë të marrë të gjitha masat e nevojshme, që çdo mbledhje e Komisionit të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes procesverbalit të mbledhjes.

2. Kryetari i Komisionit ngarkon një sekretar nga personeli administrativ i Ministrisë së Drejtësisë për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes së Komisionit.

3. Në varësi edhe të natyrës së çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e Komisionit, procesverbali i mbledhjes përmban detyrimisht dhe në mënyrë të përmbledhur:

a) datën dhe orën e fillimit e të mbarimit të mbledhjes;

b) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;

c) anëtarët e Komisionit të pranishëm;

ç) veprimet procedurale të zhvilluara në mbledhjen e Komisionit;

d) përmbledhje e diskutimeve të anëtarëve;

dh) rezultatet e votimit dhe dispozitivin e vendimeve të Komisionit për çështjet që ishin pjesë e rendit të ditës, si dhe çdo qëndrim tjetër mbajtur gjatë punimeve të mbledhjes së Komisionit.

4. Procesverbali u dërgohet menjëherë për shqyrtim anëtarëve të Komisionit të pranishëm në mbledhje, të cilët, jo më vonë se 48 orë nga dita e nesërme e ardhjes në dijeni, duhet të njoftojnë kryetarin nëse kanë vërejtje për përmbajtjen e tij.

5. Procesverbali përfundimtar iu njoftohet menjëherë pjesëmarrësve në mbledhje. Ai shqyrtohet dhe miratohet si çështje e parë e rendit të ditës në mbledhjen pasardhëse të Komisionit, pas relativitetit të kryetarit mbi kërkesat dhe korrigjimin e tij. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, si dhe nga personat e caktuar për mbajtjen e tij.

6. Procesverbali depozitohet për ruajtje, sipas legjislacionit në fuqi mbi arkivat, në sektorin e protokollit dhe arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.

KREU V

PARASHKRIMI, EKZEKUTIMI, SHUARJA DHE ADMINISTRIMI I MASAVE DISIPLINORE

Neni 27

Parashkrimi i shkeljes dhe i ekzekutimit të masës disiplinore

1. Me kalimin e afatit 2-vjeçar nga data në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, hetimet për shkeljen e pretenduar ndaj punonjësit të Policisë së Burgjeve nuk mund të fillojnë.

2. Afati i parashkrimit fillon në momentin e përfundimit të shkeljes.

Neni 28

Afatet e shuarjes së masës disiplinore

Masat disiplinore të dhëna për punonjësit e Policisë së Burgjeve, shuhen sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.

Neni 29

Pezullimi nga detyra gjatë hetimit ose procedimit disiplinor

Nëse ekzistojnë shkaqe për të vlerësuar se ushtrimi i detyrave nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit ka filluar hetimi ose procedura disiplinore, mund të dëmtojë procedurën disiplinore ose mund të dëmtojë rëndë ushtrimin e duhur të detyrave nga ky punonjës, autoriteti kompetent mund të vendosë pezullimin e punonjësit deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Neni 30

Ekzekutimi dhe administrimi i masës disiplinore

1. Masa disiplinore e dhënë ndaj punonjësit të Policisë së Burgjeve që nuk ankimohet brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, ekzekutohet dhe vendoset në dosjen personale të punonjësit, si dhe regjistrohet në sistemin e të dhënave nga strukturat përkatëse të personelit.
2. Masa disiplinore, për të cilën është bërë ankimim nga punonjësi, ekzekutohet dhe vendoset në dosjen personale të tij dhe regjistrohet në sistemin e të dhënave nga njësia përgjegjëse e personelit, pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar nga titullari ose Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore, në Ministrinë e Drejtësisë.
3. Një kopje e vendimit të marrjes së masës disiplinore administrohet nga njësia përgjegjëse e personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.